



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 185, datë 25.04.2023**

**PËR**

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES {...}**

**DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.12,NR.17 DHE NR.20 DATË 18.01.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.04.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

**VËREN**

**I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Me Vendimin nr.11- nr.24, datë 18.01.2013 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 11 deri nr.20 datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 18.01.2023, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 01.02.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr.12, nr.17 deri nr. 20 datë 18.01.2023 kandidoi edhe znj. {...}(më poshtë referuar si kandidatja) gjyqtare në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

4. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 13/2023 dhe 17/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

5. Me Vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

*“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr.11..; ;nr.24 ..., datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.*

*II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 12. Për kandidaten znj. {...}-relator z. Alban Toro;...”.*

6. Më datë 13.03.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si vendimi 320/2020), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

7. Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares.

9. Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr. 1866/1 prot., datë 17.03.2023, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

10. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër informacioni i kërkuar është përcjell me Shkresën nr.178/1 prot., datë 28.03.2023 siç do të përshkruhet më poshtë.

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT**

### **11. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale specifike minimale”**

12. “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit nr. 12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*.

13. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023, çka do të thotë se kandidatja duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

14. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015, ndërkohë ajo është emëruar për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën gusht 2015 deri qershor 2016, ku

ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile si dhe çështje penale. Në vijim, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ku dhe vijon ta ushtrojë këtë funksion duke gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme sepse kjo gjykatë nuk ka ndarje të dhomave dhe seksioneve.

15. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 13.07.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015. Me dekret nr. 8768, datë 31.10.2014 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 9651, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në datë 16.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, funksion të cilin e ushtron dhe aktualisht. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 8 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

16. Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, nga verifikimet e kryera, rezulton se kandidatja prej periudhës qershor 2016 e në vijim ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve civile, administrative, familjare, tregtare dhe penale, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër nuk pasur ndarje në dhoma dhe seksione.

17. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023, ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

#### **18. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.**

19. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të vendimit nr. 12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë ... nëse ka në fuqi një masë disiplinore.”*

20. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 01.02.2023, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.*

21. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

22. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

### **23. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.**

24. “Papajtueshmëria ambientale” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimit nr. 12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficientia e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me lëvizjen paralele, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.*

25. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 01.02.2023, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

26. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

27. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten Këshilli vlerëson se znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit

nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

### **III. KONKLUZIONE**

28. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit Këshillit nr. 12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

29. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, të procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin të tij nr. 12, datë 18.01.2023, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”; vendimit të tij nr. 17, datë 18.01.2023, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile” vendimit të tij nr. 20, datë 18.01.2023, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”,

### **VENDOSI:**

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**